



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE
DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. 2306 / Prot.

Bajram Curri, më 13 06. 2025

PROJEKT- VENDIM

Nr. _____, Date ____ . 06. 2025

PËR
VENDOSJEN E SHTATORES SË SHOTE HAKLAJ.

Këshilli i Bashkisë Tropojë, me propozim të Kryetarit të Bashkisë në mbledhjen e tij të datës ____ . ____ . 2025, bazuar në 8 pika 2, nenit 9 pika 1/1.1, shkronja “b” pika 1.7 shkronja “b”, neni 54 shkronja “ll”, neni 55 pika 2 dhe 6 të ligjit nr.139, date 07. 12. 2015 (i ndryshuar), “Për vetëqeverisjen vendore”; VKM Nr.107, date 31.07.20.14 Per planifikimin dhe zhvillimin e territorit (i ndryshuar). VKM Nr.1096, Dt. 28.12.2015 Per miratimin e rregullave, kushteve e procedurave per perdorimin dhe menaxhimin e hapësirës publike, VKM Nr. 408, Dt.13.05.2015 Per miratimin e rregullores se zhvillimit te territorit,(i ndryshuar) Ligjit nr.44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; nisur nga kërkesa e Unionit te Gazetareve te Shqiperise, me Nr. Prot. 589/1 e dates 20. 05. 2025, relacioni i datës 13 . 06. 2025, “Për mundësinë e vendosjen se nje vepre arti ne vendin e kerkua”, hartuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Keshilli Bashkiak Tropoje pas diskutimeve :

VENDOSI:

1. Të miratojë, vendosjen e shtatores së Shote Haklaj në rreth rrotullimin e pare, tek Xhamia e qytetit Bajram Curri.
2. Për zbatimin e këtij Vendimi, ngarkohen Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Drejtoria e Shërbimeve, në bashkëpunim me kërkuesit, të cilët marrin përsipër realizimin dhe zbatimin e punimeve, rregullimeve dhe çdo ndërhyrjeje në hapësirën publike, në përputhje me përmbajtjen, planvendosjen dhe qëllimin e përcaktuar në kërkesën e tyre.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 (dhjetë) ditë pas shpalljes.

Per DPZHT- ne:
Mustaf Vatoçi

Egzon Muhametaj

Hazir Isufaj

Juristi: ISIMAJ

KRYETARI I BASHKISE TROPOJE

Rexhë Byberi

NE MUNGESË DHE ME URDHER
N/ KRYETARI I BASHKISE TROPOJE

Zyra Islamaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA TROPOJE

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TE TERRITORIT

Nr. 2306/Prot.

B.Curri, më 12. 06. 2025

Lënda: RELACION.

Per vendosjen e shtatores se Shote Haklaj, me kerkesen e Unionit te Gazetareve te Shqiperise

Te nderuar z. keshilletare!

Në vijim të kërkesës së paraqitur nga **Unioni i Gazetarëve të Shqipërisë**, me Nr. Prot. 589/1, datë 20.05.2025, si dhe në zbatim të kërkesës suaj me Nr. Prot. 2458, datë 02.06.2025, për shqyrtimin e mundësisë së vendosjes së një shtatoreje në rrethrotullimin hyrës të qytetit të Bajram Currit (pranë Xhamisë), ju paraqesim këtë relacion teknik.

Pas konsultimeve të zhvilluara në terren dhe në ambientet e zyrës, si dhe në bashkëpunim me palën e interesuar, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, në përputhje me **Planin e Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Tropojë**, informon se në rrethrotullimin e propozuar si dhe në të gjitha rrethrotullimet në territorin e qytetit të Bajram Currit, dhe më gjerë në territorin e Bashkisë Tropojë, **ka mundësi të vendosen shtatore, instalacione apo vepra arti të çdo lloji, pa krijuar konflikte urbane apo shqetësime estetike dhe funksionale në raport me strukturën ekzistuese urbane.**

Përzgjedhja e figurave historike, kulturore, kombëtare etj., si dhe përcaktimi i vendndodhjes përkatëse për secilën prej tyre, mbetet për tu vlerësuar dhe vendosur nga ana juaj.

Ky relacion ka si qëllim të ofrojë **mbështetjen teknike dhe urbanistike** të nevojshme për marrjen e një vendimi të informuar dhe në përputhje me dokumentacionin planifikues në fuqi.

Me shumë respekt,


Bashklidhur keni planvendosjen e vendit të propozuar nga vete kerkuesi.

DREJTORIA E PLANIFIKIMIT DHE ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

Specialist
Mustaf Vatoci

Përgjegjës
Egzon Muhametaj

Drejtör
Hazir Isufaj



POZICIONI I VENDOSJES SE KERKUAR
SPOT NDRICIMI FORM KUBOIDI
KALIM KEMBESOR

ZYRA E URBANISTIKES	
Shkurtori i Punës Urbanistikë	
Nr. 100/2007	
Drektor: [Signature]	
PROSHTES:	
BASHKIA TROPOJE	
OBJEKTI : PLANVENDOSJE SHATORJUE	
AUTORE TE PROJEKTT:	
Mr. Tahir Isufaj	EMERTIMI I FLETES :
Ing. Edon Shkurtari	POZICIONI I VENDOSJES SE KERKUAR
Mr. Tahir Isufaj	FLETA NR:
Mr. Tahir Isufaj	SHKALLA
TEL. MUSTAF VITTO	DATE